



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 19, date 26/04/2004

**“MBI
PAGESËN E KUOTËS SË ANTARËSISË SË BASHKISË SË TIRANËS NË
SHOQATËN E BASHKIVE TË SHQIPËRISË PËR VITIN 2004”.**

Në mbështetje të Kartës Europiane të Autonomisë Lokale, neni 10, pika 1, 2, ligjit 8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” neni 8, paragrafi V, gërma “c” dhe neni 19, pika 9 dhe neni 32, ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 “Për buxhetin lokal në Republikën e Shqipërisë”, neni 18, ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.22/12/1998, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10/03/2004 “Për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2003 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2004”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës,

V E N D O S I;

1. Të miratojë pagesën e kuotës së antarësisë së Bashkisë së Tiranës në Shoqatën e Bashkësive të Shqipërisë për vitin 2004, në shumën prej 500 000 lekësh.
2. Fondi prej 500 000 lekësh të përballohet nga fondi rezervë nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë, për vitin 2004.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI